



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LIBRAZHD

Librazhd më 20/02/2024.

FTESE PËR OFERTË

Drejtuar: OJF, subjekteve të ndryshme, person fizik..

Bashkia Librazhd kërkon të realizojë “**koncert artistik për festën e 7 dhe 8 Marsit 2024**”

Ju lutemi kërkojmë të na vini në dispozicion projektin për shërbimin e kërkuar sipas specifikimeve të mëposhtme:

Një përshkrim i detajuar mbi zhvillimin e aktivitetit dhe të gjithë zërave të përfshirë në funksion të zhvillimit të aktivitetit.

Data e mbajtjes së relacionit është ditën e realizimit të aktivitetit. Duhet të jetë i firmosur në cdo faqe nga aplikuesi. Në zërat e preventivit duhet të jenë të përfshira ndër të tjera dhe fonia, orkestra, skena, këngëtar etj. Projekti duhet ti përgjigjet festimeve të mësuesve dhe festës së gruas. Aktiviteti do të realizohet në Pallatin e Sportit Librazhd.

Fondi limit është 1 000 000 (një milion) lekë me tvsh.

Kjo procedurë bazohet në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”, ligji 10 296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligji nr 119/2014 “ Për të drejtën e informimit” dhe VKB 119, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024, bashkia Librazhd”

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Përvojë dhe aftësi të mëparshme në kryerjen e një eventit artistik
- Përvojë në përgatitjen dhe/ose zbatimin e projekteve të financuara nga fondet publike, në nivel vendor;
- Njohja e bazës ligjore, dokumenteve strategjike;

Subjektet duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim në adresat: info@bashkialibrazhd.gov.al, ose pranë zyrës së protokollit, Bashkia Librazhd. Projektin dhe preventivin te firmosur.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data **01 Mars 2024**

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni në adresën:

info@bashkialibrazhd.gov.al

Njoftimi vendoset tek stenda për njoftime Bashkia Librazhd/ në web: bashkialibrazhd.gov.al

Ju faleminderit!

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

PERSONI I AUTORIZUAR

SEKRETARI I PERGJITHSHËM

Bajram PISHKASHI